VENDIM
Nr. 107, datë 2.7.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "MTC ENERGY" SHPK, PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE TË SAJ TË BARRËSUARA NGA "RAIFFEISEN BANK" SHA TEK "ALPHA BANK" SHA

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, pika 1.3 e "Licencës për prodhimin e energjisë elektrike", si dhe në zbatim të nenit 6; nenit 7 dhe nenit 8 të "Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, gjithashtu, dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 75/3 prot., datë 17.6.2020, dhe relacionin shtesë nr. 75/3-1 prot., datë 30.6.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë "MTC Energy" sh.p.k., për transferimin e aseteve të saj nga "Raiffeisen Bank" sh.a. tek "Alpha Bank" sh.a.,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 679 prot., datë 5.5.2020, shoqëria "MTC Energy" sh.p.k., ka depozituar kërkesën për miratimin e transferimit të barrësimit të aseteve të saj nga "Raiffeisen Bank" sh.a. tek "Alpha Bank" sh.a.

- Shoqëria "MTC Energy" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 227, seria PV14K, për prodhimin e energjisë elektrike, për një periudhë 30-vjeçare, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 20, datë 21.3.2014.

- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar nga shoqëria, bashkëlidhur kërkesës së sipërcituar, kjo në zbatim të nenit 7 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin nr. 119, datë 21.7.2016, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), rezulton si më poshtë:

- neni 7, pika 1, germa "a" (ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit, është plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka depozituar një ekstrakt të vitit 2018;

- neni 7, pika 1, germa "b" (veprimtaria e licencuar) është plotësuar;

- neni 7, pika 1, germa "c" (gjendja financiare e shoqërisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetevete barrësuara) është plotësuar. Në kuadër të kësaj kërkese shoqëria ka depozituar një përmbledhje të rezultateve ekonomike të shoqërisë nga fillimi i operimit të HEC-it;

- neni 7, pika 1, germa "d" (përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aseti, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e Shoqërisë që përfshihet në transaksion të tri viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare) është plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka paraqitur përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aseti;

- neni 7, pika 1, germa "e" (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit) është plotësuar;

- neni 7, pika 1, germa "f" (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit) është plotësuar;

- neni 7, pika 1, germa "g" (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar) është plotësuar;

- neni 7, pika 1, germa "h" (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen), është plotësuar pjesërisht. Nga ana e shoqërisë është depozituar marrëveshja me "Alpha Bank" sh.a., por kjo marrëveshje nuk është e shoqëruar me listën e aseteve të cilat sipas kërkesës së Shoqërisë kalojnë për barrësim në bankë;

- neni 7, pika 1, germa "i" (deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit) është plotësuar;

- neni 7, pika 1, germa "j" (nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt) është plotësuar. Shoqëria ka bërë me dije se ka nënshkruar më herët kontratë kredie me "Raiffeisen Bank" sh.a., që nga viti 2012 e, gjithashtu, ka listuar kontratat e kredisë të ndryshuara ndër vite (2012, 2014, 2014, 2015), të cilat janë të siguruara me marrëveshjet siguruese përkatëse në favor të "Raiffeisen Bank" sh.a.;

- neni 7, pika 3 (subjektet koncencionare të licencuara, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncensionit e pjesët që transferojnë te përfituesi). Kjo përfshin edhe informimin e Autoritetit Shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve, është plotësuar pjesërisht. Në marrëveshjen e transferimit të nënshkruar midis palëve janë bërë me dije detyrimet me të cilat shoqëria ngarkohet për shkak të marrëveshjes së koncencionit, ku përcaktohet dhe detyrimi i shoqërisë për të marrë konfirmimin paraprak të MIE-s, por nga dokumentacioni konstatohet se Shoqëria Koncesionare nuk ka depozituar dokumentacion i cili të vërtetojë se ka përmbushur detyrimin për të marrë miratimin e Autoritetit Shtetëror (koncensiondhënësin METE, sot MIE), në lidhje me sa kërkuar;

- neni 7, pika 4 (kërkesa, informacioni dhe dokumentacioni i bashkëlidhur kërkesës, duhet të jenë të nënshkruar nga personi ose personat e autorizuar nga shoqëria që kanë kompetencën për përfaqësimin e personit mbajtës licence apo të kandidatit të propozuar) është plotësuar.

- Shoqëria "MTC Energy" sh.pk., bën me dije se asetet e HEC "Radovë" do të vendosen peng tek "Alpha Bank" sh.a., me qëllim ristrukturimin e kredisë.

- Shoqëria në kërkesën e depozituar në ERE me nr. 679 prot., datë 5.5.2020, ka paraqitur një tabelë të vlerësimit imediat të aseteve HEC "Radovë", e cila reflektohet me dy tregues të tyre.

- Në këtë listë shoqëria ka reflektuar asete, të tilla si: linjat elektrike, punime civile, materiale dhe pajisje të cilat janë instaluar në funksion të punës së hidrocentralit "Radovë".

- Evidentohet se kjo tabelë e reflektuar nga shoqëria nuk është e vlerësuar nga auditues të jashtëm/pavarur apo nga vlerësues të pavarur. Gjithashtu, nuk disponohet një vlerësim nga banka e cila do të jetë huadhënësi për kredinë hipotekore që do t'i japë shoqërisë dhe ndërkohë do të jetë barrësuesi i këtyre aseteve sipas kushteve të kontratës së huas.

- Kontrolli i koncensiondhënësit (Autoriteti Shtetëror) prevalon mbi çdo interes të mbetur të konsiderueshëm duke kufizuar aftësinë praktike të operatorit (subjekti koncencionar) për të shitur ose dhënë peng infrastrukturën, e në kuptim të sa më sipër, Shoqëria Koncensionare duhet të marrë paraprakisht autorizim prej koncensiondhënësit për lënien peng të aseteve, si dhe të plotësojë mangësitë në dokumentacionin e paraqitur në zbatim të përcaktimeve të rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit, miratuar me vendimin nr. 119, datë 21.7.2016, të Bordit të ERE-s, por dhe si kushte të marrëveshjes së huas, shtojca 1, pika 6.5.6, miratimi i MIE-s dhe pika 6.5.7, miratimi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

- Për dokumentacionin e munguar, apo për atë që duhet të përditësohet, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit, ta paraqesë atë në Entin Rregullator të Energjisë (ERE), brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "MTC Energy" sh.p.k., për transferimin e aseteve të saj nga "Raffeisen Bank" sh.a. tek "Alpha Bank" sh.a.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti